



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Pristine datë, 27.02.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.02.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik PBC SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ri-tender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS”-2 me numër prokurimi 206-25-127-2-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

1. **Pranohet**, si pjesërisht e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik PBC SH.P.K. e dt. 21.02.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ri-tender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS”-2 me numër prokurimi 206-25-127-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 16.01.2025;
2. Anullohet Njoftimi për Kontratë të datës 16.01.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos ta anuloj, korrigoj, pastaj ta ritenderoj aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net> .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik PBC SH.P.K. me datën 21.02.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ri-tender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS”-2 me numër prokurimi 206-25-127-2-1-1**. Autoriteti Kontraktues, me datë 27.02.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

1. Neni 7 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP);
2. Neni 8 i LPP-së;
3. Neni 9 i LPP-së.

Pretendimet ankimore te OE ankues:

Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik

Autoriteti Kontraktues (AK) ka shkelur nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik gjatë përpilimit të dosjes dhe ka vazhduar në të njëjtën mënyrë edhe në përgjigjet e dhëna ndaj pyetjeve për sqarime shtesë.

1. Pyetja me numër rendor 1 ka qenë:

"Bazuar në 'Kërkesa 1' të 'Kapaciteti teknik dhe profesional', dhe duke pasur parasysh që sistemet shëndetësore në një vend nuk dalin nga përdorimi çdo tre vjet për t'u zëvendësuar me një sistem tjetër dhe se për të njëjtat nuk hapet procedurë prokurimi për mirëmbajtje pas skadimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, a është e pranueshme si dëshmi e dorëzimit implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit shëndetësor në nivel vendi, e realizuar 7 ose 8 vite më parë, duke dorëzuar kontratat, faturat dhe fletëpagesat përkatëse? Nëse jo, kjo kërkesë redukton konkurrencën, ndërsa reduktimi i konkurrencës është i ndaluar nga LPP."

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në pyetjen me numër rendor 1:

"Kërkesa për prova të projekteve në fushën e shëndetësisë gjatë tre viteve të fundit synon të sigurojë që operatorët të kenë njohuri të përditësuara dhe aftësi për të përdorur teknologji moderne. Kjo nuk kufizon konkurrencën, por garanton që operatorët të jenë të aftë për të operuar me praktikat dhe teknologjitë më të avancuara. Sistemet shëndetësore zhvillohen shpejt, dhe praktikat e vjetra mund të jenë të papërshtatshme. Kërkesa përfshin çdo institucion shëndetësor, publik apo privat, dhe synon të sigurojë që operatorët kanë eksperiencë relevante."

Kundërshtimi ynë për përgjigjen e Autoritetit Kontraktues me numër rendor 1:

☑ Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues nuk qëndron, pasi mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit do të kryhen mbi bazën e sistemit ekzistues, për të cilin nuk është kërkuar ndryshimi i teknologjive, pra janë teknologjitë e njëjta!

☑ AK nuk ka dhënë një arsyetim objektiv dhe të bazuar ligjrisht mbi përjashtimin e përvojës së mëparshme mbi të njëjtin sistem, për aq kohë sa ka kërkuar që ai të avancohet dhe të mirëmbahet.

☑ Një operator ekonomik që ka implementuar dhe mirëmbajtur sistemin e njëjtë 7-8 vite më parë nuk mund të paragjykohet si i paafël për teknologjitë moderne.

Njohuritë e përditësuara mund të dëshmohen përmes certifikimeve të kërkuara për stafin dhe përvojës në projekte sipas teknologjive përkatëse, e jo përmes kufizimit të periudhës së referencave.

☑ AK nuk ka dhënë asnjë provë objektive apo ligjore që tregon se një operator me eksperiencë të hershme nuk është i aftë të operojë me praktikat dhe teknologjitë moderne.

Nga sa më sipër, Autoriteti Kontraktues ka përjashtuar nga kualifikimi ekspertizën e së njëjtës fushë dhe të të njëjtave teknologji, ndërsa ka lejuar kualifikime që mund të jenë të fushës së shëndetësisë, por që fare nuk janë të natyrës së Basic HIS. Kjo lehtësisht mund t'iu bëjë favor atyre që kanë mirëmbajtur sisteme të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, që nuk është natyrë e Basic HIS dhe t'i përjashtojë operatorët ekonomik që kanë përvojë saktësisht në Basic HIS. Ndër tjerash, kjo bie ndesh edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës!

Kërkesa jonë për pretendimin me numër rendor 1

Bazuar në argumentet e mësipërme, konsiderojmë se përgjigja e AK-së është e pabazuar në fakte dhe ligj. Për këtë arsye, kërkojmë që:

☑ AK të modifikojë këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, duke lejuar dëshmi të projekteve të realizuara edhe më herët se tre vite më parë, për aq kohë sa kërkohet avancimi dhe mirëmbajtja e të njëjtit sistem.

☑ AK të garantojë një konkurrencë të drejtë dhe transparente, në përputhje me detyrimet e tij ligjore.

2. Pyetja me numër rendor 2 ka qenë:

"Bazuar në 'Kërkesa 4' të 'Kapaciteti teknik dhe profesional', ju lutem na njoftoni nëse është e pranueshme që për Analistin e projektit të dorëzohet diploma e inxhinierit të diplomuar në elektroteknikë ose e Doktorit të Shkencave Teknike si dëshmi ekuivalente?"

Nëse jo, kjo kërkesë redukton konkurrencën, pasi që përkufizohet vetëm në tre drejtime, ndërkohë që në treg ekzistojnë mbi 20 drejtime të kësaj fushë. Ndërsa reduktimi i konkurrencës është i ndaluar nga LPP."

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në pyetjen me numër rendor 2:

"Mund të pranohet titulli Doktor i shkencave teknike nëse është i fushës përkatëse të inxhinierise kompjuterike ose shkencave kompjuterike."

Kundërshtimi ynë për përgjigjen e Autoritetit Kontraktues për pyetjen me numër rendor 2:

- Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues (AK) nuk qëndron, pasi kufizimi i pranueshmërisë vetëm në inxhinieri kompjuterike ose shkencave kompjuterike redukton në mënyrë të panevojshme konkurrencën. Në treg ekzistojnë mbi 20 drejtime të fushës teknike, ku shumë prej tyre përmbajnë përmbajtje të ngjashme akademike dhe kompetenca të plota për të kryer rolin e kërkuar.
- Ekuivalenca e diplomave duhet të bazohet në përmbajtjen akademike dhe përvojën profesionale, dhe jo vetëm në titullin e diplomës. Diplomat në inxhinieri elektrike, elektronikë, telekomunikacion, automatizim, dhe fusha të tjera të ngjashme shpesh përmbajnë aftësi dhe njohuri që janë plotësisht të aplikueshme për rolin e Analistit të Projektit.
- AK nuk ka dhënë asnjë provë objektive apo ligjore që justifikon pse një Doktor i Shkencave Teknike ose një inxhinierit të diplomuar në elektroteknikë nuk është i përshtatshëm për këtë rol. Një kriter i tillë nuk bazohet në një analizë të kualifikimeve reale të nevojshme për detyrën, por vetëm në një përkufizim të kufizuar të fushës së studimit.

Kërkesa jonë për pretendimin me numër rendor 2

Duke marrë parasysh argumentet e mësipërme, konsiderojmë se përgjigja e AK-së është e pabazuar në fakte dhe ligj. Për këtë arsye, kërkojmë që:

- AK të modifikojë këtë kërkesë, duke pranuar diploma ekuivalente në fusha teknike të ngjashme me inxhinierinë kompjuterike dhe shkencat kompjuterike, për aq kohë sa ato përmbajnë përmbajtje të aplikueshme për rolin e Analistit të Projektit.
- AK të sigurojë një konkurrencë të drejtë dhe të hapur, siç është e detyruar me LPP-në, duke shmangur kufizimet e panevojshme në kualifikimet akademike.

3.Pyetja me numër rendor 4 ka qenë:

"Bazuar në "Kërkesën 8" të "Kapacitetit teknik dhe profesional", dhe duke pasur parasysh që mbështetja në terren për trajnime nuk lidhet me zhvillimin apo mirëmbajtjen e sistemit, a është e pranueshme që këta persona të jenë absolventë ose studentë të inxhinierisë së softuerit, të cilëve u ofrohet program Training of Trainers nga kompania jonë, se si t'i trajtojnë personelin mjekësor?"

Kjo, pasi që, duke marrë parasysh kërkesat e tregut, ku shumica e të diplomuarve në shkencat kompjuterike punësohen edhe para diplomimit, asnjë prej tyre nuk pranon të punojë si trajnues on-site ose japin dorëheqje vazhdimisht. Për këtë arsye, kjo është e vetmja mundësi që gjatë periudhës kontraktuale OE të ketë në dispozicion këto resurse."

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në pyetjen me numër rendor 4:

"Sic eshte kerkuar ne Dosjen e tenderit."

Kundërshtimi ynë për përgjigjen e Autoritetit Kontraktues për pyetjen me numër rendor 4:

- Sikurse Dosja e Tenderit të ishte e qartë dhe e ligjshme, ne fare nuk do të adresonim kërkesë për Informata shtesë. Prandaj, përgjigja e tillë bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik dhe me ato të Kodit Penal!
- Përgjigja e Autoritetit Kontraktues (AK) nuk ofron asnjë argument apo shpjegim objektiv mbi refuzimin e kërkesës, duke u kufizuar vetëm në referimin e kërkesave të Dosjes së Tenderit. Një përgjigje e tillë nuk adreson arsyetimin e ofruar në pyetje, i cili bazohet në realitetin e tregut të punës dhe nevojën për fleksibilitet në përzgjedhjen e stafit trajnues.

- Trajnimi në terren nuk lidhet me zhvillimin apo mirëmbajtjen e sistemit, por ka të bëjë me aftësinë për të komunikuar dhe instruktuar personelin mjekësor mbi përdorimin e tij. Si i tillë, nuk kërkon domosdoshmërisht diplomë të përfunduar, por njohuri të mjaftueshme teknike dhe aftësi trajnimi, të cilat mund të fitohen përmes programeve Training of Trainers (ToT) të ofruara nga operatori ekonomik.
- Kërkesa aktuale kufizon konkurrencën në mënyrë të panevojshme, pasi në tregun e punës shumica e të diplomuarve në shkencë kompjuterike angazhohen në pozicione të tjera më të kërkuara para diplomimit. Kjo krijon një sfidë praktike për gjetjen e trajnerëve të diplomuar me përvojë në terren, gjë që ndikon drejtpërdrejt në zbatimin e suksesshëm të projektit.
- AK nuk ka dhënë asnjë provë objektive apo arsytim ligjor për të përjashtuar mundësinë e përfshirjes së absolventëve apo studentëve të fushave përkatëse, për aq kohë sa ata kalojnë një program të specializuar trajnimi, i cili garanton se do të jenë plotësisht të aftë për të kryer detyrat e tyre.
- Kërkesa jonë për pretendimin me numër rendor 4
- Duke marrë parasysh argumentet e mësipërme, konsiderojmë se përgjigja e AK-së është e pabazuar dhe e paarsyetuar. Për këtë arsye, kërkojmë që:
- AK të rishikojë këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, duke lejuar përfshirjen e absolventëve apo studentëve të inxhinierisë së softuerit në këtë rol, për aq kohë sa ata marrin një program të specializuar trajnimi (Training of Trainers -ToT) për të garantuar kompetencat e tyre si trajnerë on-site.

4.Pyetja me numër rendor 5 ka qenë:

"Bazuar në "Kapacitetin teknik dhe profesional", për të gjithë stafin e kërkuar, a janë të pranueshme drejtimet ekuivalente me kërkesën?"

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në pyetjen me numër rendor 5:

"Sic eshte kerkuar ne Dosjen e tenderit."

Kundërshtimi ynë për përgjigjen e Autoritetit Kontraktues për pyetjen me numër rendor 5:

- Sikurse Dosja e Tenderit të ishte e qartë dhe e ligjshme, ne fare nuk do të adresonim kërkesë për Informata shtesë. Prandaj, përgjigja e tillë bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik dhe me ato të Kodit Penal!
- Përgjigja e Autoritetit Kontraktues (AK) është e paargumentuar dhe nuk ofron asnjë sqarim mbi bazën ligjore të refuzimit të drejtimeve ekuivalente, duke u kufizuar vetëm në një referim të përgjithshëm ndaj Dosjes së Tenderit. Një përgjigje e tillë nuk ofron transparencë dhe nuk adreson thelbin e pyetjes, e cila ka të bëjë me fleksibilitetin dhe pranueshmërinë e diplomave ekuivalente.
- AK nuk ka dhënë asnjë provë objektive apo ligjore që justifikon përjashtimin e drejtimeve të tjera ekuivalente, të cilat mund të ofrojnë kompetenca të barasvlefshme me ato të kërkuara në Dosjen e Tenderit. Një kriter i tillë është i kufizuar dhe pa bazë të qartë, duke penguar operatorët ekonomikë nga angazhimi i stafit të kualifikuar me diploma të ngjashme në fushën përkatëse.
- Diplomat ekuivalente përmbajnë kompetenca të përshtatshme dhe të aplikueshme për rolet e kërkuara, prandaj përjashtimi i tyre pa asnjë analizë të përmbajtjes akademike dhe profesionale është i padrejtë dhe kufizon konkurrencën.
- Kërkesa për diploma specifike, pa pranimin e ekuivalencave, redukton në mënyrë të panevojshme konkurrencën dhe bie ndesh me Nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i cili ndalon kufizimet e paarsyeshme dhe të pajustificuara në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Kërkesa jonë për pretendimin me numër rendor 5

Duke marrë parasysh argumentet e mësipërme, konsiderojmë se përgjigja e AK-së është e pabazuar dhe e paarsyetuar. Për këtë arsye, kërkojmë që:

▣ AK të modifikojë këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, duke lejuar pranimin e diplomave ekuivalente për të gjithë stafin e kërkuar, për aq kohë sa ato përmbajnë përmbajtje akademike dhe teknike të ngjashme me drejtimet e specifikuar në tender.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 8 dhe 9 të Ligjit për Prokurim Publik Autoriteti Kontraktues (AK) ka shkelur nenin 8 dhe 9 të Ligjit për Prokurim Publik gjatë përpilimit të dosjes dhe ka vazhduar në të njëjtën mënyrë edhe në përgjigjet e dhëna ndaj pyetjeve për sqarime shtesë.

1. Pyetja me numër rendor 6 ka qenë:

"Duke iu referuar vlerës së parashikuar dhe kohëzgjatjes së projektit, ju lutemi të na sqaroni si keni arritur në buxhetin prej 366,101.69€ pa TVSH për një periudhë prej 36 muaj dhe për angazhimin e 13 ekspertëve? Ju lutemi tregoni se si i keni përmbushur detyrimet ligjore të Nenit 8 dhe Nenit 9 i LPP, përkritazi me: 1. Si është kalkuluar paga për secilin nga ekspertët e kërkuar më poshtë? 2. Cila është kohëzgjatja e angazhimit për secilin nga ekspertët e kërkuar më poshtë? 3. Cilat janë punët dhe së është vëllimi që secili prej tyre duhet të kryejë për të përmbushur kërkesat e përshkruara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit gjatë periudhës kontraktuale? Stafi i kërkuar:

- Një - Menaxher i projektit.
- Një - Analist i projektit.
- Tre - Zhvillues të Softuerit (Programerë).
- Dy - Zhvillues të Softuerit (Programerë).
- Dy - Zhvillues të databazave.
- Katër - Staf për trajnime on-site support.

Ky informacion është thelbësor, pasi duke marrë parasysh përgatitjen profesionale të kërkuar për stafin, vëllimin e punëve të përshkruara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, si dhe pagat në tregun e Kosovës, kostoja për implementimin e këtij projekti është të paktën tre herë më e lartë se vlera e parashikuar, pa llogaritur fitimin e kompanisë dhe tatimet e aplikueshme në Republikën e Kosovës."

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në pyetjen me numër rendor 6:

"Vleresimi eshte bere bazuar ne kushtet e tregut te Kosoves, kompleksitetit apo kerkesave per mirembajtje dhe avancim te sistemit, si dhe nga kapacitetet e buxhetore te AK."

Kundërshtimi ynë për përgjigjen e Autoritetit Kontraktues për pyetjen me numër rendor 6:

Autoriteti Kontraktues për projektin me titull: "Ritender Mirembajtje e SW (Legacy Sistemeve)" ka dedikuar një buxhet prej 305,084.75 euro pa TVSH, përkundër që vëllimi i punës nuk është as sa 1/3 e vëllimit të punës së këtij projekti.

Anash kësaj:

1. Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave ligjore të nenit 9 të LPP, sepse, fare nuk ka bërë vlerësim që përcakton (i) llojin dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë.

Provë: Kërkesat e Dosjes së Tenderit, Aneks 1 - Specifikimet teknike, kapitujt:

2.1.2 Implementimi i të gjithave ndryshimeve legjislativë

2.1.6 Ndryshimet në sistem (Aplikacion dhe Database)

Prioritet 4 - avancimi i moduleve te reja jo me vone se 20 dite pune.

Nga sa me sipër, Autoriteti Kontraktues kufizon buxhetin në një rënë anë dhe kufizon afatin e kryerjes së punëve në anën tjetër, ndërsa nuk e definojnë punën që duhet të kryhet. Përveç shkeljeve të dispozitave ligjore të prokurimit publik, një rrethanë e tillë përben shkelje flagrante të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

2. Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar numrin e ekspertëve për këtë procedurë prokurimi, që pagat e tyre peshojnë hiç me pak se: Menaxher Projekti - mbi 3,000 euro bruto në muaj x 36 muaj, Analist i projektit - mbi 2,500 euro bruto në muaj x 36 muaj, 5 Zhvillues Softueri - mbi 5 x 2,500 euro bruto në muaj x 36 muaj, 2 Zhvillues të databazave - mbi 2 x 2,500 euro bruto në muaj x 36 muaj, 4 Staf për trajnime on-site - mbi 4 x 1,500 euro bruto në muaj x 36, (Provë: Deklarimet tatimore në Administratë Tatimore, por edhe në konkurse publike), e që kostoja e të cilëve, për shumë fish tejkalon buxhetin e alokuar për këtë projekt, por nuk ka asnjë matje se si ky grup i ekspertëve arrin ta implementojë vëllimin e punëve të kërkuara brenda dinamikës së kufizuar dhe brenda periudhës së kontratës, prej 36 muaj. Për më tepër që vëllimi i punëve nuk është i definuar qartë.

3. Autoriteti Kontraktues, për projektin me titull: "Zhvillimi I LIS" që për nga vëllimi i punëve është sa një nën-modul i Basic HIS (këtij projekti) ka ndarë buxhet prej 1,034,745.76 euro pa TVSH, ndërsa për komplet mirëmbajtjen, 3 vjeçare dhe për zhvillimin e 10 nën-sistemeve, ndërlihdhen e tyre me dhjetëra sosh, shkrirjen e disa sistemeve në Basic HIS, mirëmbajtjen 24/7 të tyre ka ndarë rreth 30% të shumës.

4. Autoriteti Kontraktues për projektin me titull: "Zhvillimi i modulit per IVF" ka dedikuar një buxhet prej 127,118.6441 euro pa TVSH, përkundër që vëllimi i punës nuk është as sa 10% e vëllimit të punës së këtij projekti (Basic HIS).

5. Autoriteti Kontraktues për projektin me titull: "Zhvillimi i modulit TMJISHP" ka dedikuar një buxhet prej 110,169.49 euro pa TVSH, përkundër që vëllimi i punës nuk është as sa 10% e vëllimit të punës së këtij projekti (Basic HIS).

6. Autoriteti Kontraktues, për projektin me titull "Trajnime për Stafin e SISH", ka dedikuar një buxhet prej 84,745.76 euro pa TVSH, pavarësisht se vëllimi i punës është i barabartë me trajnimet që do të mbahen për Basic HIS. Ndërkohë, për mirëmbajtjen 3-vjeçare, zhvillimin e 10 nën-sistemeve, ndërlihdhen e tyre me dhjetëra të tjera, integrimin e disa sistemeve në Basic HIS, mirëmbajtjen 24/7 dhe trajnimin, është ndarë një buxhet katër herë më i lartë. Kjo nënkupton që për një nga dhjetëra kërkesat e Basic HIS në një projekt tjetër, është ndarë një buxhet përafërsisht 10 fish me i lartë.

Prandaj, kërkojmë që:

1. Të ndërpritet kjo procedurë e prokurimi, të adresohen qartë kërkesat dhe afatet dhe të harmonizohet numri i inxhinierëve të kërkuar më vëllimin e punëve të kërkuara.
2. Të caktohet një buxhet i arsyeshëm, duke marrë për bazë kushtet e tregut, duke iu referuar të dhënave konkrete të Administratës Tatimore dhe/apo Trustit Pensional të Republikës së Kosovës.
3. Të aplikohen kriteret të përzgjedhjes që janë të matshme, të ndërlihdhura me fushëveprimin e projektit dhe të eliminohen diskriminimet.

Dëmet materiale: Dëmet materiale do të përcaktohen pas një ekspertize financiare.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet ankimore

AK-MSh i ka shqyrtuar pretendimet e juaja ankimore dhe bazuar në përmbajtjen e tyre mund të konstatojë se disa prej tyre janë të bazuara, disa pjesërisht dhe disa të pa bazuara.

Pretendimi kryesor teknik që ka të bëjë me ToR të këtij projekti është pretendimi juaj i parë se: Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues nuk qëndron, pasi mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit do të kryhen mbi bazën e sistemit ekzistues, për të cilin nuk është kërkuar ndryshimi i teknologjive, pra janë teknologjitë e njëjta!

Në lidhje me këtë pretendim ne ju sqarojmë se me këtë projekt për AK-MSh është e nevojshme që krahas mirëmbajtjes të behet edhe avancimi i sistemit ekzistues. Për avancimin e sistemit ekzistues, te pika 2 e ToR – "Shërbimet e kërkuara për mirëmbajtje dhe avancim" njëra nga pikat është upgrade te teknologjive që janë përdorur në zhvillim të aplikacionit në teknologjitë me te reja.

Pas shqyrtimit të ToR ne si AK e kemi vërejtur se kjo pike e upgrade te teknologjive nuk është e detajuar aq sa duhet dhe është e nevojshme të plotësohet me përmbajtje më të detajuar të komponentëve dhe modaliteteve të funksionimit, andaj duke e ditur rëndësinë e projektit dhe me qëllim të realizimit sa më të suksesshëm të këtij projekti, e konsiderojmë se zgjidhja më e drejtë është anulimi dhe ri-tenderimi i këtij aktiviteti, pasi të bëhet përmirësimi i ToR.

- Në lidhje me pretendimin rreth referencave në tre vitet e fundit dhe mundësisë për marrjen parasysh të referencave me afat më të gjatë, ose 7 deri 8 vite më parë për implementimin dhe mirëmbajtjen sistemit të njëjtë, ky pretendim është I pa bazuar, meqenëse kërkesa është ligjore dhe rrjedh nga dispozita e saktë, referuar A02 Udhëzuesit Nr. 001-2023 për prokurim, ku specifikohet si në vijim:

3. Aftësitë teknike dhe/ose profesionale

Në rast të kontratës për furnizim të produkteve:

b) Vlera minimale në lidhje me shërbimet në 3 vitet e fundit

- Në lidhje me pretendimin për mundësinë e lejimit të diplomave ekuivalente, konsiderojmë se edhe ky pretendim është pjesërisht i bazuar dhe kjo kërkesë do të jete subjekt i trajtimit gjatë shqyrtimit të specifikave para se të ri-tenderohet.

- Në lidhje me pretendimin për kualifikimin e trajnerëve dhe përvojën e tyre, konsiderojmë se edhe ky pretendim është pjesërisht i bazuar, diplomimi i trajnerëve është i domosdoshëm ndërsa sa i përket përvojës, mund të zbutet kërkesa gjatë shqyrtimit të specifikave para se të ri-tenderohet.

- Në lidhje me pretendimin për mundësinë e lejimit të diplomave ekuivalente, konsiderojmë se edhe ky pretendim është pjesërisht i bazuar dhe kjo kërkesë do të jete subjekt i trajtimit gjatë shqyrtimit të specifikave para se të ri-tenderohet.

- Në lidhje me pretendimin rreth stafit të kërkuar në Raport me shumen e projektit, konsiderojmë se ky pretendim është pjesërisht i bazuar dhe kjo kërkesë do të jete subjekt i trajtimit gjatë shqyrtimit të specifikave para se të ri-tenderohet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. OE PBC SH.P.K.
3. Operatorëve ekonomik të interesuar.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit